



## Asociacioni i Komunave të Kosovës

---

# RAPORT

<b>Për:</b>	<b>Ertan Munoglu – Menaxher i Programit</b>
<b>Nga:</b>	<b>Fisnik Dashi – Koordinator për Kolegjiume</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv</b>
<b>Data :</b>	<b>03 shkurt 2011</b>
<b>Subjekti :</b>	<b>Raport nga takimi i Kryesisë së Kolegjiumit për Arsimit dhe Kulturë</b>

### HYRJE

Kryesia e Kolegjiumit për Arsim dhe Kulturë mbajti mbledhjen e rregullt të saj si dhe të parën për vitin 2011 me datën 21 janar 2011. Në këtë takim ishin prezent z. Azem Guri – Kryesues, z. Qerim Selimi – Zv.kryesues dhe anëtarët e tjerë z. Nexhmi Rudari dhe znj. Fahrije Kryeziu, ndërsa dy anëtarët tjerë mungonin për arsye të ndryshme. Në takim poashtu ishin prezent edhe z. Ertan Munoglu – Menaxher i Programit në AKK, si dhe z. Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve në AKK.

Takimi kishte për qëllim përcaktimin dhe diskutimin e pikave të rendit të ditës për takimin e radhës së Kolegjiumit për Arsim dhe Kulturë, si dhe përcaktimin e prioriteteve për vitin 2011.

### PËRMBLEDHJE

Mbledhjen e hapi z. Azem Guri me prezantimin e pikave të rendit të ditës:

- Raporti i punës së Kolegjiumit qershor-dhjetor 2010 dhe Plani i punës për janar-qershor 2011
- Analiza e suksesit të gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2010/11
- Gjendja aktuale në arsimin para-universitar dhe hapat e mëtejme
- Formula e re e financimit, dhe
- Provimi shtetëror i maturës

### **1. Raporti i punës së Kolegjiutit qershor-dhjetor 2010 dhe Plani i punës për janar-qershor 2011**

Kryesuesi, z. Guri pastaj kaloi në pikën e parë të rendit të ditës theksuar se në takimin e radhës së kolegjiutit do të prezantohë Raportin e Punës për periudhën qershor-dhjetor 2010, si dhe do të diskutohet plani i punës dhe prioritetet për periudhën janar-qershor 2011. Kryesuesi poashtu theksoi se ka kontaktuar me zyrtarë të MASHT-it për të mbajtur takime të rregullta me zyrtarët e saj, mirëpo deklaroi se momentalisht MASHT nuk do të ketë takime me drejtorë deri në formimin e qeverisë së re.

z. Munoglu paraqiti një dokument udhëzues për përgatitjen e planit të punës për 2011, i cili ka për qëllim t'i ndihmoj kolegjiuteve në identifikimin e prioriteteve, objektivave dhe aktiviteteve si dhe të unifikoj planet e punës për të gjitha kolegjiutet. Ky dokument do të diskutohet gjatë takimit të ardhshëm kur bëhet plani për vitin 2011.

### **2. Analiza e suksesit të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2010/11**

z. Guri kërkoi që z. Selimi të përgatis një raport lidhur me suksesin e gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2010-2011 i cili do të prezantohet dhe diskutohet në takimin e radhës. z. Selimi theksoi se po punon në analizën e suksesit të gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor, dhe se të dhënat do të jenë të gatshme në takimin e radhës të Kolegjiutit. Të dhënat janë në nivel të Kosovës dhe statistikave e komunave/shkollave nuk dalin reale, andaj edhe duhet të bëhen krahasimet me MASHT-in për raportin e suksesit, si dhe të nxirren rekomandimet dhe ndërmerren masat për të përmirësuar gjendjen. Një ndër problemet mbetet dallimi i madh i vlerësimit të nxënësve në gjysmë-vjetorin e parë (sukses i dobët) dhe në përfundim të vitit shkollor (përmirësim i dukshëm i suksesit). z. Rudari shtoi se suksesi gjithmonë është i përafërt me vitin paraprak andaj duhet të pyetemi se a është ky një vlerësim real. Sa i përket vlerësimit të dobët në gjysmë-vjetorin e parë, duket se kjo përdoret qëllimisht nga mësuesit për të disiplinuar nxënësit, andaj edhe duhet të ketë një diskutim serioz se cilat duhet të jenë rekomandimet dhe hapat të cilat Kolegjiuti duhet të ndërmarrë në përmirësimin e situatës duke pasur parasysh se kjo ka qenë në planin e punës së Kolegjiutit për Arsim për vitin e kaluar. z. Selimi shtoi se një arsye tjetër e vlerësimit të dobët mund të jetë edhe nxitja e nxënësve për të marrë orë shtesë private, për të cilat paguajnë mësuesit e tyre. Për të adresuar të gjitha këto çështje kërkohet një analizë më e thellë në bazë të klasave, ku duhet të hulumtohen se cilat janë arsyet apo pengesat të një rezultati të tillë, si dhe kërkohet një presion mbi drejtorë të shkollave/mësues që gjatë vlerësimeve të tyre të jenë sa më real. Poashtu kërkohet të institucionalizohet çështja e pagesës së orëve shtesë mësimore për t'i ikur vlerësimeve të qëllimshme të dobëta.

### **3. Gjendja aktuale në arsimin para-universitar dhe hapat e mëtejme**

Një temë tjetër që do diskutuar është edhe ajo e gjendjes aktuale të edukimit para-universitar, ku znj. Kryeziu do të përgatis rekomandimet lidhur me problemet që kanë të bëjnë me: pagesën për mësime të cilët dalin në pension gjatë vitit shkollor (meqë ka problem të mëdha teknike rreth pagave për ata mësues të cilët vazhdojnë punën deri në përfundim të vitit), sëmundjet e rënda kronike të mësimeve (ka raste ku mësime të cilët janë në komë ato vuajnë nga sëmundje shumë të rënda të cilat nuk lejojnë vazhdimësi në mësime dhe poashtu paraqesin problem me pushime mjekësore), pushimin e lehonisë, transportit të nxënësve, etj. Adresimi i këtyre çështjeve duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarë të MASHT-it, prandaj rekomandimet e znj. Kryeziut do të ndihmonin në këtë proces. Poashtu në takim u diskutua nëse duhet kërkuar sqarim lidhur me pagave të stafit teknik (të cilët do t'i hiqen shtesat), por meqë stafi teknik është kategori e shërbyesve civil, dyshohet se Kolegjiuti mund të bëjë diçka rreth kësaj.

#### **4. Formula e re e financimit**

Decentralizimi i buxhetit nga komuna në shkolla këtë vit bëhet vetëm në pilot komunitat për arsye se komunitat tjera (dhe shkollat e tyre) nuk kanë njohuri të mjaftueshme apo kanë mungesë të kapaciteteve për menaxhim të buxhetit. Për më tepër edhe dy komuna pilot do të mbajnë buxhetin në nivel të komunës (përfshirë Podujevën) për shkak të problemeve me lista të pagave kundruall numrit të nxënësve, ndërrimit të shpeshtë të drejtorëve të shkollave, problemeve me zbatim të ligjit të prokurimit nga shkollat si dhe mungesës së zyrtarit financiar në çdo shkollë.

z. Guri theksoi se komunitat janë të obliguara të kenë komisionet për planifikim zhvillimor tre-vjeçar dhe përgatitjen e buxhetit të cilët duhet të merren me këto çështje. Ai poashtu theksoj edhe problemet në lidhje me zëvendësimin e drejtorëve, të cilët pas trajnimit (të ofruar nga Banka Botërore) për menaxhimin financiar largohen dhe lënë boshllëk deri tek trajnimi i drejtorit të ri. Andaj menaxhimi financiar i shkollave paraqet problem mjaft serioz i cili kërkon zgjidhje për aplikimin e suksesshëm të formulës së re të financimit.

#### **5. Provimi shtetëror i maturës**

Provimi i maturës pritet të ndërroj këtë vit, por ende nuk dihet cilat do të jenë ndryshimet. Sidoqoftë kryesia kërkoj nga z. Rudari të paraqesë analizën mbi këto çështje të provimit të maturës: administrimi, menaxhimi, vëzhguesit, përmbajtja e testit, etj., dhe të nxirren rekomandimet se çfarë duhet të ndryshohet për të përmirësuar provimin e maturës. Lidhur me këtë temë po ashtu u përmend se këtë vit nuk do të ketë provim pranues për universitet dhe se provimi i maturës është ai që do të merret për bazë gjatë pranimit në universitet, andaj vlerësimi duhet të jetë sa me korrekt duke marrë për bazë parregullsitë e shumta gjatë viteve të kaluara. Heqja e provimit pranues konsiderohet të jetë e rrezikshme sepse rezultatet e provimit të maturës janë të fryra, duke marrë parasysh kopjimin, apo ndihmën e mësuesve apo drejtorëve të shkollave gjatë procesit. Një çështje e rëndësishme është ajo e procesit të vëzhgimit të provimit të maturës, ku rekomandohet që të angazhohen mësime dhënësit e mësimit klasor si palë e cila nuk është direkt e lidhur me procesin e mësime dhënies të nxënësve të cilët do ti nënshtrohen provimit të maturës. Kërkohet bashkëpunim i ngushtë me MASHT-in në identifikimin e problemeve në procesin e administrimit dhe vëzhgimit të provimit të maturës si një sfidë për një të ardhme sa më të mirë të gjeneratave të reja.

#### **6. Takimi i radhës**

Komisioni për fund vendosi që takimi i Kolegjiumi për Arsim dhe Kulturë të mbahet me datën 4 shkurt (e premte) 2011. Anëtarët ranë dakord që stafi i AKK-së të jetë përgjegjës për përgatitjen e ftesave, dhe sigurimit të ambientit ku do të mbahet mbledhja.